



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 164, datë 18.12.2020

PËR ZMADHIMIN E KAPITALIT PËR SHOQËRINË AKSIONARE “REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1” SH.A, NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 81, pika 1, shkronja “ë”, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", të ndryshuar, vendimit nr. 335, datë 04.05.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca Studentore nr. 1” sh.a., Tiranë, “Trajtimi i Studentëve nr.2” sh.a. Tiranë dhe “Trajtimi i Studentëve nr. 3 “ sh.a. Tiranë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes tek Bashkia Tiranë”, vendimit nr.45, datë 29.04.2020, të Këshillit Bashkiak “Për nisjen e procedurave të bashkimit me përthithje të shoqërisë “Ndërmarrja e Trajtitimit të Studentëve nr. 3” sh.a nga shoqëria përthithëse “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1”, sh.a Tiranë; vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, kërkesës së shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, Sh.a me nr. 1541/1prot., datë 12.10.2020, si edhe në vijim të memos 42810 prot, datë 04.12.2020 “Mbi rritjen e kapitalit të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 sh.a”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “Rezidenca Studentore nr. 1” sh.a,

V E N D O S I:

1. Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1,” Sh.a. me anë të emetimit të aksioneve të reja nga aksioneri i vetëm Bashkia Tiranë, në vlerën prej 43,448,849 lekë (dyzet e tre milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë) lekë, me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secili aksion, duke e rritur numrin e përgjithshëm të aksioneve në 8,174,327.849 (tetë milione njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e shtatë dhe tetëqind e dyzet e nëntë të mijta), si edhe vlerën e përgjithshme të kapitalit në shumën 8,174,327,849 (tetë miliard e njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e dyqet e nëntë) lekë.
2. Zmadhimi i kapitalit të pasqyrohet në nenin përkatës të Statutit të shoqërisë “Rezidenca Studentore Universitare nr. 1,” Sh.a si dhe të regjistrohët në Regjistrin e Aksioneve të shoqërisë.
3. Ngarkohen administratori i shoqërisë që të njoftojë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për zmadhimin e kapitalit.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e miratuara në Programin e Zhvillimit, art 232 parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2020.
5. Ngarkohen shoqëria Rezidenca Studentore Universitare nr. 1,” Sh.a dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO